



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
BORDI

VENDIM

Nr. 157, Datë 30.06.2021

MBI

**RISHIKIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS DHE REGJISTRIT TË
KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TË ERE**

Në mbështetje të neneve 10, pika 1 dhe nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 2, pika 1, germa “a”, 4, 5, 6, 7 dhe 8, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), si dhe Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar” të KDIMDP, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 30.06.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 96/7 prot., datë 28.06.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi rishikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të ERE ”,

Konstatoi se:

- ERE në kuptim të nenit 10, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe neneve 2, pika 1, germa “a”, 4, 5, 6, 7 dhe 8, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është Autoritet Publik, i cili në kuptim të parashikimeve të këtij Ligji ka detyrimin e vënies në zbatim të një Programi institucional Transparence dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, si dhe rishikimin e tyre rast pas rasti.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 69, datë 11.05.2015, ka vendosur miratimin dhe zbatimin e programeve të transparencës së ERE, parashikuar në nenin 4, të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- Në vijimi, bordi i ERE-s me vendimin nr. 112, datë 27.07.2017, vendosi rishikimin e programit të transparencës së ERE.
- Në zbatim të Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar” të KDIMDP, si dhe Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020, “Për

miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar” të KDIMDP, Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve të ERE iu nënshtruan rishikimit sa përcaktuar në këto dy Urdhra.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rishikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të ERE (Bashkëlidhur).
2. Ngarkohet Koordinatorin për të Drejtën e Informimit të ERE për implementimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve sipas këtij vendimi dhe lidhjeve bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

PROGRAMI I TRANSPARENCËS SË ERE




Figura nr.1 Programi i Transparencës




Figura nr. 2 Rreth Autoritetit




Figura nr.3 Kuadri ligjor rregullator/Tekstet e plota




Figura nr. 4 E drejta për t'u Informuar dhe për t'u ankuar




Figura 5 Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë në ERE




Figura nr. 6 Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të ERE




Figura nr. 7 Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat




Figura nr. 8 Shërbimet që ofrohen nga ERE




Figura nr. 9 Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të ERE




Figura nr. 10 Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve




Figura nr. 11 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve




Figura nr. 12 Ndihma Shoqërore/subvencione të dhëna nga ERE




Figura nr. 13 Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga ERE

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa